

KRUSLIN kundër FRANCËS **HUVIG kundër FRANCËS**

Në dy vendime që dha në lidhje me çështjet Kruslin kundër Francës dhe Huvig kundër Francës, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se përgjimet telefonike të bëra nga oficerë të policisë gjyqësore, të ngarkuar me këtë detyrë nga gjykatësi i hetimeve paraprake përbëjnë shkelje të nenit 8 të Konventës përderisa nuk parashikohen në mënyrë të qartë dhe të hollësishme nga e ligji francez, dhe duke mos përmbushur kështu një nga kushtet e justifikueshmërisë së masës së kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 8. Ky vendim është i rëndësishëm sidomos në lidhje me përcaktimin e termave “siguri dhe qartësi juridike” dhe “ligj” sipas kuptimit të Konventës Europiane.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Faktet kryesore

1. Në prill 1985, dhoma e akuzimit e Gjykatës së Apelit të Tuluzës, e dërgon Z. Jean Kruslin përpara Gjykatës Penale të Garonës së Sipërme, për tu përgjigjur si bashkëpunëtor i një vrasjeje me qëllim, i një vjedhje në rrethana rënduese dhe i një tentative për vjedhje në rrethana rënduese. Një nga elementet e dosjes ishte regjistrimi i një bisede telefonike të bërë nga kërkuesi më 17 qershor 1982, me një linjë që i përkiste një personi tjetër. Ky regjistrim ishte bërë me kërkesën e një gjyqtari të hetimeve paraprake të Saint-Gaudens në kuadrin e një procedure tjetër. Gjykata e Kasacionit hedh poshtë kërkesën e bërë nga i interesuari.

2. Z. Jacques Huvig, i cili drejton një shoqëri tregtare me ndihmën e gruas së tij, Janine, është bërë subjekt i një ankese për një mashtrim fiskal, mosmbyllje të llogarive tregtare dhe mbyllje të pasakta të llogarive. Në kuadrin e një hetimi të hapur nga gjykatësi i hetimeve paraprake të Shomon, ky i fundit ngarkon policinë e Langres për të përgjuar dhe transkriptuar të gjitha bisedat telefonike tregtare dhe private të të interesuarëve. Përgjimet janë bërë për rreth 28 orë me rradhë gjatë muajit prill 1974.

3. Të akuzuarit, Zoti dhe Zonja Huvig u dënuan në mars 1982 nga gjykata e Shkallës së Parë të Shomon për pothuajse të gjitha shkeljet për të cilat ata duhet të përgjigjeshin. Në mars të vitit 1983, Gjykata e Apelit të Dizhonit e konfirmon këtë gjykim por i rëndon dënimet e shpallura. Gjykata e Kasacionit e hedh poshtë, në prill 1984, kërkesën ankimore të ankuesve.

B. Procedurat përpara Komisionit European të të Drejtave të Njeriut

4. Përpara Komisionit, i cili u mbledh më 16 tetor dhe 1985 dhe 9 gusht 1984, Z. Kruslin dhe bashkëshortët Huvig denoncuan vënien nën përgjim të telefonave të tyre si dhe dëgjimin e bisedave të tyre, në shkelje të Nenit 8 të Konventës.

5. Në opinionet e tij të 14 dhjetorit 1988, Komisioni formulon mendimin sipas të cilit ka patur shkelje të Nenit 8 (dhjetë vota kundër dy).

II. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË 24 PRILLIT 1990 (dhomë) (seria A nr. 176-A dhe B)

A. Në lidhje me nenin 8 të Konventës

6. Duke konstatuar që përgjimet e ankimuara në çështjen në fjalë përbënin ndërhyrje të autoritetit publik në ushtrimin e të drejtës të të interesuarve për respektimin e paprekshmërisë të korrespondencës dhe të jetës së tyre private, Gjykata kërkon nga ana tjetër në se ndërhyrje të tilla mund të justifikoheshin në bazë të paragrafit të 2 të Nenit 8.

7. Në radhë të parë, a ishin ato «të parashikuara nga ligji»? Këto terma të fundit kërkojnë para së gjithash që masa ndaj së cilës ngrihet akuza të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por ato kanë të bëjnë gjithashtu me cilësinë e ligjit në fjalë: ato kërkojnë mundësinë e personit përkatës që t'i njohë ato, i cili për më tepër duhet të ketë mundësi të parashikojë pasojat për atë vetë, dhe se sa pajtohet ai me parimin e përparësisë të së drejtës.

8. Pyetja për të kuptuar në se kushti i parë ishte përmbushur i la vend një debati. Ankuesit iu përgjigjën asaj në mënyrë negative. Sipas mendimit të qeverisë franceze, me «ligj» duhet kuptuar «e drejta në fuqi në një sistem juridik të dhënë», dhe si rrjedhim tërësia e përbërë nga e drejta e shkruar - kryesisht Nenet 81, 151 dhe 152 të Kodit të Proçedurës Penale - dhe nga jurisprudenca që i interpreton ato. Përsa i përket referentit të caktuar nga Komisioni, ai deklaronte që në rastin e vendeve «kontinentale», ndër të cilët bën pjesë edhe Franca, veçse një tekst normativ me efekt të përgjithshëm - i votuar ose jo nga Parlamenti - mund të konsiderohet si një «ligj» në kuptimin e Nenit 8 § 2 të Konventës.

9. Gjykata kujton se u takon së pari autoriteteve kombëtare, dhe në mënyrë të veçantë gjykatave, që të interpretojnë dhe të zbatojnë të drejtën e brendshme. Nuk i përket pra asaj që të shprehë një opinion të kundërt me atë të tyre në lidhje me pajtueshmërinë e përgjimeve gjyqësore me Nenin 368 të Kodit Penal. Tashmë, qysh prej disa vjetësh, një seri gjykimesh dhe vendimesh, dhe në veçanti të Gjykatës së Kasacionit, ka konsideruar se Nenet 81, 151 dhe 152 të Kodit të Proçedurës Penale përbënin bazën ligjore të përgjimeve të vëna në jetë nga një oficer i policisë gjyqësore i ngarkuar me këtë detyrë posaçërisht nga një gjyqtar të hetimeve paraprake. Ajo çmon se nuk mund të bëjë abstraksion të një jurisprudence të tillë, të qartësuar në këtë drejtim tashmë. Në fushën e paragrafit 2 të Nenit 8 të Konventës dhe të klauzolave të tjera analoge me të, ajo e ka shtrirë gjithmonë kuptimin e termit «ligj», në një konceptim të tijin material dhe jo formal, duke përfshirë në të edhe tekste të rangut nënligjor, si dhe të drejtën e pashkruar. Si përfundim, ndërhyrjet që ishin bazë e gjykimit kishin një bazë ligjore në të drejtën franceze.

10. Kërkesa e dytë që del në pah nga kuptimi i shprehjes «i parashikuar nga ligji», mundësia për tu njohur me këtë të fundit pra, nuk nxjerr asnjë problem.

11. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë në lidhje me të tretën, «mundësia e parashikimit» të ligjit përse i përket kuptimit dhe natyrës së masave të zbatueshme.

Përgjimet si dhe format e tjera të ndërhyrjes në bisedat telefonike përfaqësojnë një cënim të rëndë ndaj respektimit të jetës private dhe të korrespondencës. Për këtë arsye, ato do të duhej të bazoheshin në një «ligj» të një saktësie të veçantë. Ekzistenca e rregullave të qarta dhe të detajuara në këtë fushë duket e domosdoshme, duke patur parasysh që edhe proçedurat teknike që përdoren, nuk rreshtin së përfeksionuari nga ana e tyre.

12. Qeveria pohonte se Gjykata nuk duhet të gjykonte në parim në lidhje me pajtueshmërisë e legjislacionit francez me Konventën, ashtu sikur të vendoste *de lege*

*ferenda*¹. Ajo parashtronte një listë prej shtatëmbëdhjetë garancish që do të gjenin zbatim në këtë rast sipas së drejtës së brendshme. Këto garanci kishin të bënin si me realizimin e përgjimeve, si me përdorimin e rezultatit të nxjerrë prej tyre, ashtu, së fundi, edhe me mjetet për të arritur vënien në vend të parregullsive të mundshme; ankuesit nuk kanë qënë privuar nga asnjëra prej tyre.

Gjykata nuk minimizon aspak vlerën e shumë prej tyre. Ajo konstaton nga ana tjetër që vetëm disa prej tyre dalin në pah nga kuptimi i vetë termave të Neneve 81, 151 dhe 152 të Kodit të Proçedurës Penale. Të tjerat dalin në pah nga gjykimet dhe vendimet e shprehura gjatë rrjedhës së viteve, në mënyrë të pjesshme, dhe, në shumicën e tyre dërmuese, pas përgjimeve për të cilat ankohen pala ankuese. Në këtë kuptim nuk e ka sanksionuar qartë as jurisprudenca deri tani. Mbi të gjitha, sistemi nuk ofron ende për momentin një mbikqyrje të përshtatshme kundër abuzimeve të ndryshme për të cilat mund të dyshohet. Për shembull, asgjë nuk i përcakton kategoritë e personave të cilët mund të vihen nën përgjim gjyqësor, as natyrën e shkeljeve që mund të gjejnë vend aty; asgjë nuk e kufizon gjyqtarin në lidhje me caktimin e një kufiri të kohëzgjatjes së vënies në zbatim të këtyre masave; asgjë për më tepër nuk saktëson kushtet e krijimit të proçes-verbaleve të përmbledhura të bisedave që kanë qënë përgjuar, as masat parandaluese që duhen marrë me qëllim që të komunikohen të paprekura dhe të plota regjistrimet e realizuara, për qëllimet e një kontrolli eventual nga ana e gjyqtarit - i cili nuk do të kishte aspak mundësi që të shkonte në vend për të verifikuar vetë numrin si dhe gjatësinë e shiritave magnetikë origjinalë - dhe nga ana e mbrojtjes gjithashtu, e së fundi asgjë nuk përcakton as rrethanat në të cilat do të mundej ose të të duhej të proçedohet me fshirjen ose me eliminimin e shiritave të përmendur në sipër, kjo sidomos në rast pabazueshmërie ose pafajësie. Udhëzimet e dhëna nga ana e qeverisë në lidhje me këto pika nxjerrin më mirë në pah ekzistencën e një praktike, të zhveshur nga një forcë detyruese në mungesë të një teksti normativ ose të jurisprudencës.

Si përmbledhje, e drejta franceze, e shkruar ose jo e shkruar, nuk parashikon me një qartësi të mjaftueshme shtrirjen dhe mënyrat e ushtrimit të pushtetit të vlerësimit nga ana e autoriteteve në fushën e marrë në konsideratë. Kjo gjë mund të thuhet edhe më me forcë në lidhje me kohën kur kanë ndodhur faktet e të dy çështjeve, për shkak se ankuesit nuk kanë gëzuar asnjë shkallë minimale të mbrojtjes të kërkuar nga parimi i përparësisë të së drejtës në një shoqëri demokratike. Ka patur pra një shkelje të Nenit 8 të Konventës (*në unanimitet*).

13. Ky përfundim e shkarkon Gjykatën nga kontrolli në lidhje me respektimin e kërkesave të tjera të parashikuara nga paragrafi 2 i Nenit 8, domethënë qëllimi dhe nevoja e vënies në jetë të ndërhyrjes së lartpërmendur.

B. Në lidhje me nenin 50 të Konventës

14. Duke u mbështetur në Nenin 50, Z. Kruslin pretendonte një shpërblim prej 1 000 000 Franga Franceze për shkak të dënimit të tij me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie, si dhe rimbursimin e 70 000 Franga Franceze të shpenzuara për pagesa dhe honorare avokatie gjatë proçedurave të brendshme nacionale.

Gjykata hodhi poshtë kërkesën e tij të parë sepse konstatimi i shkeljes i ofron kërkuar një shpërblim mjaftueshmërisht të barazvlefshme me dëmin e ankuar. (*në unanimitet*). Ajo, nga ana tjetër, pranon pjesërisht kërkesën e dytë, duke e ngarkuar

¹ *De lege ferenda* - nga latinishtja që do të thotë "bëj ligj", "ligjëroj". Në këtë rast është përdorur si "hartoj dispozita ligjore" (*shën. i përkth.*)

Francën që të paguajë shumën prej 20 000 Franga Franceze të nevojitura për një procedurë në Gjykatën e Kasacionit *(në unanimitet)*.

15. Bashkëshortët Huvig nuk reklamuan as reparacion dhe as rimbursim të pagesave dhe të shpenzimeve.

Duke qënë se kjo çështje nuk shtronte nevojën e një shqyrtimi kryesisht, Gjykata vendos që nuk ka vend për zbatimin e Nenit 50. *(në unanimitet)*²

² Ligji Nr. 91-646 i 10 korrikut 1991 në lidhje me karakterin sekret të korrespondencave të dërguara në rrugë telekomunikacioni ka qënë botuar në Gazetën Zyrtare të 13 korrikut 1991. Ai shton një Nen 100 në Kodin e Proçedurës Penale, që ka të bëjë me ndërhyrjet e urdhëruara nga autoriteti gjyqësor.